



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**AC-I-22-0568**

***Në ankesën e***

***Paditësi***

**I C**, i përfaqësuar nga av. **B I**, nga Prishtina,  
**kundër**

***E paditura/Ankuesja***

**NSH "Magjistralka"** Prishtinë (në likuidim), përfaqësuar nga, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1765, të datës 28 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 18 tetor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1765, i datës 28 shtator 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me datë 03 korrik 2013, paditësi e dorëzoi në DHPGJS-së një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN032-0231, të datës 31 maj 2013, me të cilën kërkesa e paditësit për kompensim të pagave të pa paguara, për periudhën janar 2006-dhjetor 2006, në shumë prej 5.927,28 euro, refuzohet si e pa vlefshme me arsyetimin se paditësi nuk ka kryer asnjë shërbim pune për ndërmarrjen për periudhën e cekur. Kjo ankesë ishte grupore dhe ishte regjistruar me numër fillestar C-IV-13-1216. Pastaj pas urdhrit të Gjykatës, paditësi e dorëzoi një parashtesë për rregullimin dhe plotësimin e padisë e cila u regjistrua si ankesë dhe ka marrë numrin C-IV-15-1765. Paditësi në ankesë pohon se Autoriteti i Likuidimit nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike pasi që ai pohon se e kishte pranuar letër pezullimin nga AKM-ja, me të cilën dëshmohet se ai ka punuar deri me 22 maj 2007. Tutje paditësi pohon se NSH-ja e paditur ishte obliguar ti paguaj pagat për periudhën e cekur. Me këtë ankesë paditësi ka kërkuar edhe kamatën ligjore si dhe shpenzimet e përfaqësimit.

Me datë 14 shkurt 2020, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pretendon se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat materiale. AKP-ja pohon se ankesa është e pa pranueshme pasi që është paraqitë pas afatit, dhe është pa asnjë verë ligjore. Tutje pohon se parashtesa për rregullim dhe plotësim të padisë për veq që është e pa pranueshme, ajo nuk bazohet në gjendjen faktike të vërtetuar nga Autoriteti i Likuidimit. AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit ka kompetencë të vlerësoj se paga është një e drejtë që buron nga marrëdhënia e punës për punën e kryer, ndërsa paditësi nuk mund të vlerësohet se ka kryer ndonjë punë për NSH në periudhën e cekur, andaj nuk mund të pretendon paga ndaj NSH-së. Tutje AKP-ja pohon se lista e 20% nuk ka asnjë ndikim lidhur me kompensimin e pagave të pa paguara. AKP-ja në mbrojtje në ankesë ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. AKP-

### III

ja me mbrojtje në ankesë ka bashkangjitur, vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, fletë kthesën për pranimin e vendimit të Autoriteti të Likuidimit.

Me datë 03 qershor 2022, paditësi e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen në mbrojtjen në ankesë, në të cilën ai i kundërshtoi pretendimet e AKP-së si të pa bazuara në ligj, dhe i mbështeti pohimet e veta të paraqitura në ankesë. Bashkë me këtë parashtresë paditësi ka bashkangjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit, Librezën e punës e mbyllur me 13 prill 2007, lista të pagave të punëtorëve të pa paguara për periudhën janar 2006-dhjetor 2006, Aktin përcjellës të Drejtorit të NSH-së me të cilin dërgohen Listat e pagave në Zyrën rajonale të AKP-së në Prishtinë, një Deklaratë nën Betim të Drejtorit të NSH-së, kopjen e Letërnjoftimit të Drejtorit të NSH-së, Kopjen e Kontratës së punës, Aktvendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës të datës 21.06.2007, një Referencë, dhe një Regjistër të punëtorëve dhe të dhënat gjatë lëvizjes në punë.

Me datë 14 korrik 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundërpërgjigjen, në të cilën ajo pohoi se ankuesi nuk ka dorëzuar asnjë provë për të dëshmuar se ka punuar deri në momentin e privatizimit të NSH-së, andaj ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar. AKP-ja i përsërit edhe pretendimet e tjera të cekura në mbrojtjen në ankesë.

Me datë 28 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1765, ankesën e paditësit e aprovon si të bazuar, e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit PRN032-0231 të datës 31 maj 2013 , dhe e obligon Autoritetin e Likuidimit që ta paguaj paditësit në emër të pagave të papaguara për periudhën janar 2006-dhjetor 2006, shumën prej 5.927,28 euro, në emër të interesit ligjor prej 10%, në borxhin kryesor, shumën prej 592,72 euro, dhe në emër të shpenzimeve të përfaqësimit shumën prej 134,00 euro, që do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së arsyeton se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat i vendimit të AKP-së për shitjen-privatizimin e NSH-së, dhe se me datë 22 maj 2007, gjë e cila vërtetohet me kopjen e

#### IV

Librezës së punës e mbyllur me këtë datë. Shkalla e I-rë konstaton se paditësi ka ofruar edhe kopjen e listës së pagave për periudhën janar-dhjetor të vitit 2006 e nënshkruar nga personat e autorizuar të NSH-së në të cilën listë është edhe paditësi. Sipas Listës së pagave paditësi e kishte pagën mujore prej 493,94 euro, e që në periudhën janar 2006-dhjetor 2006(për 12 muaj), paditësit i njihet shuma prej 5.927,28 euro. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se vendimi i Autoritetit të Likuidimit me të cilën është refuzuar pjesa e kërkesës për pagat e pa paguara në shumë prej 5.927,28 euro, është i pa bazuar pasi që ky vendim bazohet në vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike dhe në kundërshtim me provat të cilat paditësi i ka ofruar në gjykatë. Tutje shkalla e I-rë konstaton se e paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë që do të vërtetonte se paditësi nuk ka ofruar shërbime pune për NSH-në në periudhën e lartcekur.

Me datë 19 tetor 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1765 të datës 28 shtator 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit, dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja pohon se me Aktgjykimin e ankimuar nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike, është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale dhe nuk janë marrë në konsideratë argumentet ligjore të dhëna në vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe në mbrojtjen në ankesë. Tutje AKP-ja pohon se gjetjet faktike të gjykatës janë tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes dhe plotësisht të pa bazuara në ndonjë dokument që ekzistojnë në dosje të lëndës. AKP-ja pohon se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes nuk ka marrë parasysh faktin se paditësi nuk ka qenë në Listën e pagave për periudhën e cekur . Tutje AKP-ja në ankesë pohon se paditësi nuk ka saktësuar cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur, duke pohuar se DHPGJS-ja ka kompetencë të shqyrtoj vetëm ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se gjykata duhet të lëshohet në shqyrtimin e çështjes dhe të marrë në konsideratë argumentet e ngritura të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 03 dhjetor 2022, paditësi e pranoi ankesën e AKP-së, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 12 korrik 2007, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit të NSH "Magjistranja" (në likuidim), një kërkesë për kompensim të pagave të pa paguara për periudhën janar 2006 - dhjetor 2006, në shumë prej 5.927,28 euro, e cila kërkesë pjesërisht ishte pranuar në shumë prej 130,51 euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës ishte refuzuar në shumë prej 5.796 euro, me arsyetimin se paditësi nuk ka ofruar shërbime pune për NSH-në dhe nuk ka qenë në Listën e pagave.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-15-1765 të datës 28 shtator 2022, e aprovon ankesën e paditësit, e ndryshon Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, dhe e detyron AKP-në-Autoritetin e Likuidimit që ti paguaj paditësit në emër të pagave të papaguara për periudhën janar 2006-dhjetor 2006, shumën prej 5.927,28 euro, në emër të interesit ligjor prej 10%, në borxhin kryesor, shumën prej 592,72 euro, dhe në emër të shpenzimeve të përfaqësimit shumën prej 134,00 euro, që do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së

arsyeton se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat i vendimit të AKM-së për shitjen-privatizimin e NSH-së, dhe se me datë 22 maj 2007, gjë e cila vërtetohet me kopjen e Librezës së punës e mbyllur me këtë datë. Shkalla e I-rë konstaton se paditësi ka ofruar edhe kopjen e listës së pagave për periudhën janar-dhjetor të vitit 2006 e nënshkruar nga personat e autorizuar të NSH-së në të cilën listë është edhe paditësi. Sipas Listës së pagave paditësi e kishte pagën mujore prej 493,94 euro, e që në periudhën janar 2006-dhjetor 2006, paditësit i njihet shuma prej 5.927,28 euro.

Duke i vlerësuar provat që paditësi i ka sjellë në shkallën e I-rë , vendimin e Autoritetit të Likuidimit, Librezën e punës e mbyllur me 13 prill 2007, lista të pagave të punëtorëve të pa paguara për periudhën janar 2006-dhjetor 2006, Aktin përcjellës të Drejtorit të NSH-së me të cilin dërgohen Listat e pagave në Zyrën rajonale të AKP-së në Prishtinë, një Deklaratë nën Betim të Drejtorit të NSH-së, kopjen e Letërnjoftimit të Drejtorit të NSH-së, Kopjen e Kontratës së punës, Aktvendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës të datës 21.06.2007, një Referencë, dhe një Regjistër të punëtorëve dhe të dhënat gjatë lëvizjes në punë, shkalla e I-rë e me të drejtë e ka aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar, e ka ndryshuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, dhe e ka obliguar AKP-në ti paguaj paditësit pagat e papaguara nga muaji janar 2006-dhjetor 2006, në shumë prej 5.927,28 euro, si dhe intresin ligjor prej 10% në borxhin kryesor në shumë prej 592,72 euro, duke u bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Kolegji i Apelit i mbështetë të gjeturat faktike dhe konstatimet e shkallës së I-rë të dhëna në Aktgjykimin e ankimuar, të cilat i konsideron si të drejta dhe të mbështetura në prova.

Kopja e Librezës së punës dhe Listat e pagave si dhe provat tjera të sjellura në procedurën e shkallës së I-rë të DHPGJS-së, janë prova të mjaftuara për njohje të të drejtës së pretenduar në paga.

## VII

Andaj nga se u tha më lartë, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar, nuk ka mundësi të ndryshohet, andaj ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksa gjyqësore**

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, në shumë prej 100 euro me datë 10 nëntor 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 tetor 2023

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_